

VENDIM
Nr. 40, datë 19.1.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 207, DATË 10.3.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PËR PERSONELIN, MJEKË,
INFERMIERË DHE PUNONJËS TË TJERË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4, e vendimit nr. 207, datë 10.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Lista emërore e përfituesve dhe dokumentacioni justifikues, përfshirë ditët e angazhimit, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, me qëllim përfitimin e shpërblimit, miratohet periodikisht me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në analizën e shkallës së ngarkesës së veprimtarisë dhe të riskut, që mbart aktiviteti i strukturës shëndetësore, e cila vlerësohet nga sekretariati i ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Sekretariati përbëhet nga:

- a) 2 përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- b) 1 përfaqësues i Institutit të Shëndetit Publik;
- c) 1 përfaqësues i Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor;
- ç) 1 përfaqësues i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2022.

KRYEMINISTËR
Edi Rama